

## **SIGURIMI I PASAGJERËVE**

### **OBJEKTI I SIGURIMIT**

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik. Ky sigurim mbulon vdekjen dhe dëmtimet trupore të shkaktuara pasagjerit sipas mbulimit të përcaktuar në nenin 19, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Pasagjerë janë personat që udhëtojnë me njërin nga mjetet e transportit të destinuara për transportin publik, pavarësisht nëse kanë blerë një biletë, përfshirë personat që kanë të drejtë të udhëtojnë pa pagesë, si dhe personat të cilët ndodhen në territorin e stacionit, të molit, portit, aeroportit ose pranë mjeteve të transportit, para se të hipin ose janë duke zbritur, të cilët kanë qëllim të udhëtojnë ose që kanë udhëtuar me njërin nga mjetet e transportit, me përjashtim të personave të punësuar në mjetin e transportit. Personat që gjenden në avion, në shkallë ose në kabinë pa autorizimin e pronarit të avionit ose të ekuipazhit, nuk vlerësohen si pasagjerë.